



	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË	
REKTORATI			
Nr. / Br. / No. <u>1953</u>		Nr. / faq / Br. str / No. pg <u>12</u>	
Data / Datum / Date: <u>02.08.2018</u>		Pejë / Poë	

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Adresa; Rruga e UCK-së, 30000 Pejë, Republika e Kosovës, Nr tel + 381 039 432 270, info@unhz.eu

RREGULLORE PËR PUNËN E PARLAMENTIT STUDENTOR NË UNIVERSITETIN
"HAXHI ZEKA" - PEJË

2018

Në mbështetje të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Nr. 04 – V – 662, të datës 30 Maj 2013, neni 155, paragrafi 5, si dhe Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës 04/L-037, Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" me datë 13.07.2018, miraton:

Rregulloren për Punën e Parlamentit Studentor në Universitetin "Haxhi Zeka" - Pejë

I. Dispozitat e Përgjithshme

Qëllimi

Neni 1

Kjo rregullore përcakton kriteret, standardet dhe procedurat themelore mbi funksionimin e Parlamentit Studentor të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, me qëllim të funksionalizimit të organeve përfaqësuese studentore, nëpërmjet përcaktimit të fushëveprimtarisë, duke përfshirë kompetencat dhe përgjegjësitë, ndersa detajet tjera do të rregullohen hollësisht në dispozitat vijuese të kësaj rregullore.

Ajo që nuk është rregulluar në mënyrë eksplicite në paragrafin 1, përkitazi me punën e Parlamentit Studentor, do të rregullohet me hollësisht në dispozitat vijuese të kësaj Rregullore.

II. Njoftimi, verifikimi dhe revokimi i mandateve të anëtarëve të Parlamentit Studentor

Neni 2

- 1) Mbledhjen konstituive të parlamentit studentor (në tekstin e metejm: PS) e therret dhe e kryeson Sekretari i Përgjithshern derisa të zgjedhet kryetari përkates.
- 2) Mbledhjet konstituive thirren pas përfundimit të periudhës së caktuar për njoftimet e mandateve dhe refuzimin e mandateve, duke u bazuar në nenin 48 dhe 49 të Rregullores për Zgjedhjet Studentore të Universitetit. Ftesa duhet të bëhet për secilin mandatar në mënyrë individuale nga kryesuesi i komisionit zgjedhor.
- 3) Refuzimi (mospranimi) i mandateve duhet të bëhet ashtu siç parashihet në nenin 49, paragrafi 4 i Rregullores për Zgjedhje Studentore të Universitetit. Mandatari zëvendësues duhet të zgjedhet nga lista zyrtare e kandidatëve, ashtu siç parashihet në Rregulloren për Zgjedhjet Studentore të Universitetit dhe zëvendësimi duhet zyrtarisht t'i paraqitet Sekretarit të Përgjithshëm, nga kryetari i organizatës përkatëse studentore brenda afatit prej 3 ditëve të punës.
- 4) Procedura e zëvendësimit për mandatar nuk duhet të ketë ndonjë efekt të shtyrjes dhe duhet të i përrnbahet procedurave dhe orareve për konstituim dhe funksionim të mëtutjeshëm të organeve studentore.
- 5) Në rast të refuzimit të njëpasnjëshern të mandateve nga personat pasues në listë të kandidatëve, dhe nëse lista nuk posedon kandidatë tjerë, atëherë Komisioni Qendror Zgjedhor (në tekstin e rnetejm KQZ), duhet të kërkojë nga kryesuesi i organizatës përkatëse studentore nominimin e kandidatit të ri, brenda periudhës prej 3 ditëve të punës. Ky kandidat duhet të plotësojë parakushtet ashtu siç parashihen në këtë Rregullore, në të kundërtën KQZ brenda afatit prej shtatë ditëve jep arsyetimin me shkrim për shkaqet e refuzimit.
- 6) Gjatë procedurës së rinominimit të mandatit, i cili mandat paraprakisht është refuzuar nga i nominuari fillestar, ky mandat formalisht nuk duhet të pengojë funksionimin e punës në organin përkatës, mandati as nuk mund të delegohet dhe as nuk mund të llogaritet për kuorum.
- 7) Mandati i dhënë anëtarëve të PS mund të tërhiqet në çdo kohë nga Parlamenti i Studentëve me vota të shumicës absolute të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të PS, kur konsiderohet se është cenuar kodi etik, përkatësisht dispozitat përkatëse të kësaj Rregullore janë shkelë.

Ankesat përkatëse mund të dorëzohen pranë Këshillit Drejtues nga secili anëtar i organit përkatës. Procedura e rinominimit duhet të bëhet ashtu siç parashihet në këtë nen.

- 8) Parlamenti i studentëve përmes konsultave, në këto detyra funksionale ndihmohet nga Këshilli Drejtues dhe Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit.

Mandati

Neni 3

- 1) Mandati i anëtarëve të PS fillon me 1 Tetor të vitit kur janë mbajtur zgjedhjet studentore.
- 2) Mandati i anëtarëve të PS zgjatë për një periudhë prej dy vitesh, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një vit.
- 3) Në mbledhjen konstituive të PS mandati i secilit anëtar duhet të verifikohet nga Sekretari i Përgjithshëm ose zyrtari të cilin ai e autorizon, duke u bazuar në listën zyrtare të rmandatarëve e cila është pergatitur nga komisioni për zgjedhje studentore.
- 4) Verifikimi i mandateve duhet të regjistrohet në procesverbal të mbledhjes. Mandatarët të cilët nuk mund të verifikohen duke u bazuar në dokumentacionin përkatës të komisionit për zgjedhje studentore, të njejtët duhet të largohen nga mbledhja. Sekretari i Përgjithshëm kërkon nga organizata përkatëse studentore të bëjë rinominimin e mandatarëve ashtu siç parashihet në këtë Rregullore.

Betimi

Neni 4

Me fillimin e mandatit të tyre, secili anëtar i PS duhet të nenshkrua kodin etik si me poshtë: "Deklaroj se do t'i kryej detyrat e mija me nderë dhe besnikëri, me drejtësi dhe pa anim, me integritet dhe përgjegjësi dhe do të kontribuoj në përmbushjen e detyrave të PS dhe do të ushtroj mandatin tim me vigjilencë dhe përkushtim në interes të Universitetit dhe se do t'i përmbahem rregullave të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, të cilin betim anëtari i PS duhet t'a lexoj para të pranishmëve dhe anëtarëve të tjerë.

III. Zgjedhja dhe shkarkimi i Kryetarit dhe Sekretarit të Parlamentit Studentor

Neni 5

- 1) Kryetari i PS duhet të zgjedhët me vota të shumicës absolute nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të PS. Propozimet për kandidatë duhet të bëhen gjatë mbledhjes të kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe duhet të votohen ashtu siç parashihet në Rregullore.
- 2) Nëse asnjëri nga kandidatët e propozuar nuk e fiton shumicën absolute të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në radhën e parë të votimit, atëherë organizohet radha e dytë e votimit për kandidatin me numër më të madh të votave. Nëse kandidati që nuk e merr shumicën e votave absolute edhe në radhën e dytë të votimit, atëherë kandidati konsiderohet i refuzuar dhe procedura zgjedhore rifillohet sipas paragrafit 1 të këtij neni, në këtë rast kandidati i refuzuar paraprakisht, largohet nga kandidatura.
- 3) Në rast të votave të barabarta, votimi përsëritet dy herë. Nëse prap ka vota të barabarta pas këtyre dy radhëve të votimeve, procedura zgjedhore duhet të rifillojë sipas paragrafit 1 të këtij neni.
- 4) Në rast se asnjë kandidat nuk arrinë shumicën absolute të votave pas tri radhëve të votimit të njëpasnjëshëm ashtu si parashihet në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, atëherë radha e katër e vendimtare e votimit duhet të mbahet me tre kandidatët paraprak të refuzuar si kandidatët e vetem, Kandidati i cili fiton shumicën e thjeshtë të votave duhet të zgjedhet si

- kryetar i ri. Në rast të votave të barabarta, kandidatët me më së shumti vota të fituara garojnë në radhën e dytë të votimit.
- 5) Në rast se votat mbeten të barabarta edhe pas tri radhëve të njëpasnjëshme të votimeve sipas paragrafit 4 të këtij neni, mbledhja konstituive ndërpritet dhe thirret përsëri nga Sekretari i Përgjithshëm brenda 48 orëve.
 - 6) Pas mbledhjes konstituive të përsëritur, të gjithë kandidatet e refuzuar gjatë proceduarave paraprake të votimit duhet të perjashtohen nga kandidatura për pozitën e Kryetarit. Procedura zgjedhore pastaj duhet të rifilloi duke u bazuar në dispozitat e këtij neni.
 - 7) Pas zgjedhjes së Kryetarit, zgjedhët sekretari me shumicën e thjeshtë të votave përmes votimit të hapur.
 - 8) Pas kryerjes së zgjedhjes së Kryetarit dhe sekretarit, Sekretari i Përgjithshëm i'a dorëzon udhëheqjen e mbledhjes Kryetarit, ndërsa procesverbali i dorëzohet sekretarit.

Shkarkimi Neni 6

- 1) Kryetari mund të shkarkohet nga funksioni i tij me shumicën absolute të votave përmes një votimi në bazë të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të PS.
- 2) Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të kryetarit, nenkryetari i pari e merr kryesimin e përkohshëm dhe brenda shtatë ditëve e thërret takimin për rizgjedhje të kryetarit.
- 3) Sekretari mund të shkarkohet nga funksioni i tij me shumicën absolute të votave përmes një votimi duke llogaritur numrin e anëtarëve të pranishëm të PS.
- 4) Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të sekretarit, kryetari cakton njërin nga dy nënkryetarët pa ndonjë vonesë, përkohësisht në marrjen e obligimeve të sekretarit dhe duhet të caktojë një pikë në rendin e ditës të po atij takimi për zgjedhjen e sekretarit të ri.

V. Zgjedhja dhe shkarkimi i Nënkyetarit të Parlamentit Studentor Neni 7

- 1) PS mund të zgjedhë deri në dy nënkryetar, Vendimi për këtë numër mund të merret me votim të hapur me shumicën e thjeshtë të votave.
- 2) Kryetari / kryesuesi dhe secili nga nënkryetarët / zëvendës kryesuesit duhet të jetë nga organizata të ndryshme studentore.
- 3) Secili nënkryetar / zëvendës kryesues duhet të zgjedhët në votime të ndara me shumicën e thjeshtë të votave. Propozimet për kandidatë bëhen njëkohësisht gjatë takimit dhe pastaj votohen në pajtim me këtë Rregullore.
- 4) Pas çdo përfundimi të votimit, kandidatët e organizatës së njëjtë studentore hiqen nga lista e kandidatëve, kandidatët e mbetur vazhdojnë në votimin pasues.
- 5) Në rast të votave të barabarta, mund të mbahen deri në tri votime në mes të dy kandidatëve me më së shumti vota. Nëse nuk arrihen rezultate pas tri votimeve të njëpasnjëshme, kandidatët hiqen nga lista dhe propozohen kandidatët e rinj.
- 6) Zëvendësimi i kryetarit / kryesuesit nga njëri prej nënkryetarëve / zëvendës kryesuesve duhet të respektojë rrjedhën e zgjedhjeve, p.sh. nënkryetari / zëvendës kryesuesi i parë i zgjedhur vepron si nënkryetari / zëvendës kryesuesi i parë.
- 7) Nënkyetari / zëvendës kryesuesi mund të shkarkohen nga funksioni me shumicën absolute të votave përmes një votimi duke llogaritur numrin e plotë të anëtarëve të PS.
- 8) Në rast të dorëheqjes apo shkarkimit të nënkryetarit / zëvendës kryesuesit, kryetari / kryesuesi thërret mbledhjen për rizgjedhje të nënkryetarit / zëvendës kryesuesit brenda shtatë ditësh.

VI. Mbledhjet
Neni 8

- 1) Kryetari / kryesuesi (në tekstin e mëtejshëm - kryesuesi) i thërret dhe i kryeson mbledhjet.
- 2) Nëse kryesuesi nuk ka mundësi të kryesojë mbledhjen, atëherë sipas rregullës II mutatis mutandis" zbatohet edhe për nënkryetarët / zëvendës kryesuesit të cilët merren me kryesimin e mbledhjes. Në rast se të gjithë nënkryetarët / zëvendës kryesuesit nuk kanë mundësi të marrin pjesë në mbledhje, atëherë sekretari merr kryesimin e mbledhjes. Në këtë rast, rendi i ditës duhet të përmbajë një pikë, caktimi i mbledhjes brenda 48 orëve.
- 3) Kryesuesi thërret takimet e PS sipas nevojës. Gjatë periudhës së studimeve, mbledhjet e rregullta të PS duhet të mbahen së paku njëherë në muaj.
- 4) Takimet e jashtëzakonshme të PS mund të mbahen në çdo kohë sipas procedurave të parapara, mirëpo rendi i ditës duhet të kufizohet në një pikë. Gjatë mbledhjes së PS mund të përcaktohet edhe takimi pasues. Në këtë rast anëtarët që mungojnë në mbledhje të PS duhet të ftohen veçmas.
- 5) Në rast të shkarkimit apo dorëheqjes së kryetarit / kryesuesit dhe të gjithë nënkryetarëve / zëvendës kryesuesve, atëherë Sekretari i Përgjithshëm në emër të Këshillit Drejtues duhet të aranzhojë procedurat zgjedhore pa ndonjë vonesë.
- 6) Mbledhjet e PS duhet të jenë të hapura për publik, përveç në ato raste kur PS vendos ndryshe.
- 7) Anëtarët e PS duhet të ftohen nga sekretari së paku 3 ditë para mbajtjes së mbledhjes, ftesa mund të bëhet me shkrim, përmes e-mailit apo përmes metodave tjera teknike ku postimi deri te i adresuari është i sigurt.
- 8) Kryesuesi ka të drejtë në çdo kohë në mbledhje të ftojë ekspertë për mbështetje profesionale.
- 9) Kryesuesi është i obliguar të thërrasë mbledhjen pa vonesë nëse një gjë e tillë kërkohet nga një e treta e anëtarëve të PS dhe nëse propozimi me shkrim ka arsye të fortë. Paraqitësit e kërkesës kanë të drejtë të kërkojnë nga nënkryetari i parë ose zëvendës kryesuesi të thërrasë mbledhjen e PS duke lënë jashtë kryesuesin.

VII. Pjesëmarrja në mbledhje, zëvendësimi
Neni 9

- 1) Të gjithë anëtarët e PS kanë të drejtë dhe janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhje të organit përkatës.
- 2) Gjatë takimeve të PS anëtarët votojnë vetëm personalisht.
- 3) Delegimi i votës nuk është i lejuar.
- 4) Anëtarët duhet të nënshkruajnë listën e pjesëmarrjes në secilin takim të PS, lista e pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e procesverbalit të mbledhjes e cila përgatitet dhe distribuohet nga sekretari. Anëtarët mund të mungojnë për shkaqe të arsyeshme dhe për këtë duhet të njoftohet me kohë kryesuesi.
- 5) Anëtarët të cilët nuk e arsyetojnë mungesën e tyre 3 herë rradhazi atëherë ai/ajo automatikisht largohet nga PS. Kryesuesi/ja është i/e obliguar që të kërkojë përmes një shkresë nga kryetari i organizatës përkatëse që të njejtin t'ua zëvendësoi me anëtarin vijues në listën e të kandiduarve për Parlament Studentor, e këtë me së largu në afat prej 15 ditësh nga pranimi i shkresës, nga ana e kryetarit të organizatës.



Konflikti i interesit

Neni 10

- 1) Anëtari konsiderohet se është në konflikt interesi nëse arsyet që paraqiten korrespondojnë me rregullat përkatëse të ligjeve të Kosovës dhe Statutit të UHZ-së në fushat e konfliktit të interesit privat, publik dhe të funksionit.
- 2) Në rastet e konfliktit të interesit në kuptimin e këtij neni, e që mund të lindin nga interesat personale të tilla, PS nuk do të merr vendime dhe nuk do të lëshohet në diskutimin e temave të veçanta, përderisa anëtari i njëanshëm t'a leshojë takimin deri në perfundim të asaj teme.
- 3) Anëtarët që kanë konflikt interesi nuk mund të votojnë për tema të tilla.
- 4) Vendimet për përjashtimin e një anëtari nga tema apo takimi për arsye të konfliktit të interesit, mund të kontestohen brenda dy ditëve përmes një deklarate me shkrim e cila i adresohet Këshillit Drejtues. Për kontestimin duhet të vendoset brenda 7 ditëve. Në rast të pranimit të kërkesës, çështja duhet të rivendoset në rend të ditës për mbledhjen vijuese të organit përkatës dhe të gjitha vendimet paraprake konsiderohen si të pavlefshme.

VIII. Fillimi i mbledhjes dhe aprovimi i rendit të ditës

Neni 11

- 1) Kryesuesi e hapë, e kryeson, e ndërpreu dhe mbyllë mbledhjen.
- 2) Rendi i ditës duhet të përgatitet nga kryesuesi në bashkëpunim me nënkryetarët / zëvendës kryesuesin dhe sekretarin.
- 3) Kryesuesi është i obliguar të përfshijë kërkesat me shkrim në rend të ditës, të cilat kanë qenë të dorëzuara me kohë, p.sh. me së voni 72 orë para mbledhjes dhe të cilat kanë bazë. Në kërkesat me shkrim duhet të vendoset nënshkrimi origjinal i paraqitësit dhe ajo mund të dorëzohet me faks, e-mail, apo përmes metodave tjera teknike kur dergimi është i sigurt.
- 4) Mbledhjet e PS duhet të kenë koorumin prej 50+1 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
- 5) Në fillim të mbledhjes, kryesuesi konfirmon anëtarët pjesëmarrës dhe ata në mungesë dhe pasi siguron koorumin, propozon rendin e ditës, hap diskutimin për rendin e ditës, konfirmon aprovimin e rendit të ditës dhe e vazhdon takimin sipas pikave të rendit të ditës.
- 6) Kryesuesi u'a jep fjalën anëtarëve për diskutim, siguron përfundimin e diskutimit për një mori temash, vendosë çështjet në votim, konfirmon aprovimin apo refuzimin e propozimeve, ndërmerr masa të duhura për t'u siguruar që takimi ka progres, deklaron mbylljen e takimit dhe ndërmerr aktivitete tjera të nevojshme për të kryesuar mbledhjen në pajtim me rregulloren.
- 7) Anëtarët e PS kanë të drejtë të propozojnë ndryshime apo përfshijnë pika në rendin e ditës dhe duhet të i justifikojnë propozimet.
- 8) Materialet apo kërkesat e dorëzuara gjatë takimit mund të aprovohen me shumicën absolute të votave.

IX. Rrjedha e mbledhjes

Neni 12

- 1) Pas aprovimit të rendit të ditës, vazhdohet me diskutime për çështjet brenda kornizave të rendit të ditës.
- 2) Raporti dhe justifikimi për secilën pikë të rendit të ditës prezantohet nga kryesuesi apo personi i caktuar nga kryesuesi, pastaj kryesuesi hap diskutimin.
- 3) Të gjithë anëtarët e pranishëm të PS mund të marrin pjesë në diskutim dhe të paraqesin pikëpamjet dhe propozimet për çështjet për të cilat do të vendoset në mbledhje.

- 4) Kryesuesi i jep fjalën secilit anëtar që kërkon fjalën sipas radhës. Në mbledhje askush nuk mund të diskutojë pa l'u dhënë fjala nga kryesuesi.
- 5) Kryesuesi është përgjegjës që rregullorja e punës të respektohet dhe që anëtarët të sillen sipas rregullit.
- 6) Për secilën pikë të rendit të ditës një anëtar mund të diskutoi deri dy herë, herën e parë deri në 5 minuta dhe herën e dytë deri në 2 minuta.
- 7) Kryesuesi ka të drejtë të i'u përkujtojë anëtarëve që t'i kthehen pikës së rendit të ditës.
- 8) Anëtar i cili e merr fjalën është i obliguar të i përmbahet temës për të cilën diskutohet. Secili anëtar i cili konsideron se është penguar gjatë diskutimit, me aprovim të kryesuesit ka të drejtë të marrë fjalën përsëri dhe të i përgjigjet folësit paraprak i cili e ka apostrofuuar. Replika për çështjet e njejta është e lejueshme vetëm dy herë dhe ajo mund të zgjasë deri në dy minuta.
- 9) Kryesuesi ka të drejtë të ndërpres mbledhjen për më së shumti 30 minuta. Me pelqim të anëtarëve të PS kjo periudhe kohore mund të zgjatet.
- 10) Kryesuesi është i obliguar të ndërpres punimet e mbledhjes nëse ai / ajo e konsideron veten jo të aftë të vazhdoi takimin në mënyrë të rregullt.
- 11) PS me propozim të kryesuesit apo ndonjë anëtar tjetër të organit përkatës, mund të vendos që për vendimet e çështjeve specifike të pergatiten detaje dhe te percillen në takimin vijues.

Kërkesat

Neni 13

- 1) Secili anëtar i PS ka të drejtë të paraqesë kërkesë për temen aktuale.
- 2) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë që kërkesa të bëhet me shkrim.
- 3) Kërkesat për rregulla procedurale duhet të justifikohen shkurtimisht. Sipas kërkesës për një "pro" dhe një "kundër" folësit duhet të i jepet fjala.
- 4) Kërkesat për rregulla procedurale mund të dorëzohen për dy arsye:
 - a) kërkesa për mbylljen e regjistrimit të folësve: nëse mocioni kalon më shumicën e thjeshtë të votave, vetëm folësit e regjistruar në listë në kohën e bërjes së kërkesës kanë të drejtë të marrin fjalën.
 - b) Kërkesa për përfundim të debatit: nëse mocioni kalon më shumicën e kualifikuar 2/3 e votave, diskutimi merr konkluzion dhe kërkesat e mbetura pezull mbesin për t'u votuar.

X. Vendimmarrja - votimi dhe zgjedhja

Neni 14

- 1) Vendimet e PS duhet të kenë kuorumin prej 50+1 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të organit përkatës në mënyrë që të jetë i vlefshëm.
- 2) Para votimit, kryesuesi formulon propozim vendimin apo kërkesën duke u bazuar në temën e rendit të ditës.
- 3) Pas formulimit të vendimit dhe rishikimit, sipas kërkesës dhe pikave në rend të ditës PS
- 4) miratohet vendimi dhe nxirren konkluzione.
- 5) PS merr vendim me shumicën absolute të votave të gjithë anëtarëve të pranishëm.
- 6) Nëse ka me shumë kërkesa, së pari votohet për atë që janë në materialet e propozuara dhe pastaj votohet për propozime tjera.
- 7) Votimi bëhet përmes aklamacionit, me ngritje dore apo përmes votes së fshehtë. Kjo vendoset në mënyrë individuale gjatë takimit PS me shumicë të thjeshtë votash.
- 8) Votimi bëhet:
 - "për"

- "kundër"
 - "abstenim"
- 9) Në rast të votave të barabarta, kërkesa konsiderohet si e refuzuar.
 - 10) Procedura e votimit të fshehtë zbatohet nga komisioni i përbërë prej tre anëtarëve të caktuar nga PS. Këta anëtarë zgjedhën me shumicën e thjeshtë të votave.
 - 11) Pas votimit të gjithëve, kryesuesi konfirmon aprovimin apo refuzimin në bazë të rezultatit të votimit.

Votimi i fshehtë
Neni 15

- 1) Votimi përmes votes së fshehtë në Parlamentin Studentor mund të kërkohej për:
 - a) Zgjedhjen e studentëve senatorë në Senat;
 - b) Zgjedhjen e kryetarit;
 - c) Zgjedhjen e nënkryetarit;
 - d) Shkarkimin e kryetarit;
 - e) Shkarkimin e nënkryetarit;
 - f) Shkarkimin e sekretarit;
 - g) Çështjet për të cilat kryesuesi kërkon të bëhen me votë të fshehtë;
 - h) Çështjet për të cilat shumica absolute e anëtarëve kërkon votim të fshehtë;
- 2) Numërimi i votave për këto çështje do të bëhet nën mbikëqyrjen e sekretarit.

XI. Nominimet në Këshillin Studentor për listën e anëtarëve të kandiduar për Senat dhe për Parlamentin Studentor
Neni 16

- 1) Nominimi i kandidatëve duhet të bëhet me një pikë të paraparë të rendit të ditës. Votimi duhet të bëhet në pikën vijuese. Në mes të dy pikave në rendin e ditës, duhet të caktohet një kohë prej 10 minutave për sekretarin që të përgatisë listën në mënyrë alfabetike dhe me numrin rendor të kandidatëve.
- 2) Për secilin kandidat të propozuar duhet të paraqitet një biografi e shkurtë dhe kualitetet kryesore përmes një raportimi prej 2 minutave. Referimet e tilla nuk bënë të tejkalojnë kohën prej 5 minutave për një kandidat. Referimet e mëtejme për secilin kandidat bëhen në pajtim me këto rregulla.
- 3) Lista prej tre të nominuarve për anëtarë të studentëve në Senat të cilët duhet të zgjidhen nga Parlamenti Studentor bëhet përmes votes së fshehtë me fletëvotim.
- 4) Fletëvotimet kufizohen në tri rrundesi votimi, ku rrumbullakohen numrat para kandidatëve të preferuar sipas prioritetit.
- 5) Fletëvotimet të cilat përmbajnë më shumë se tre numra të kandidatëve të rrethuar konsiderohen si të pavlefshme.
- 6) Të tre kandidatët me më së shumti pika të votimit duhet të kalohen të Parlamenti Studentor për votim.
- 7) Në rast të votave të barabarta, kandidatët në fjalë duhet të votohen prap në votimin e dytë sipas rregullave të përshkuara më lartë.
- 8) Nëse votat mbeten të barabarta pas tri votimeve të njëpasnjëshme, vendimi për kandidatët duhet të merret përmes shortit.
- 9) E tere proedura e votimit duhet të zhvillohet perrnes komisionit zgjedhor i perbere prej tre anetareve, ne perberje te sekretarit dhe dy anetareve tjere (duke perjashtuar kryesuesin dhe zevendes krvesuesin), te cilet zgjidhen nga KSme shumice te thjesht votash.



XII. Zgjedhjet e Parlamentit Studentor për studentët anëtarë të Senatit

Neni 17

- 1) Secili Këshill i Studentëve në Fakultete ka të drejtë të paraqes listën prej tre kandidatëve për anëtarët student të Senatit për t'u zgjedhur nga parlamenti studentor.
- 2) Anëtarët e Senatit duhet të zgjedhën me votë të fshehtë përmes fletëvotimit.
- 3) Në fletëvotimet të cilat duhet të përgatiten paraprakisht nga Sekretari, mund të rrrumbullakohen numrat e shtatë kandidatëve me të preferuar sipas prioritetit.
- 4) Fletëvotimet të cilat përmbajnë më shumë se shtatë numra të rrrumbullakuar të kandidatëve konsiderohen si të pavlefshme.
- 5) Të tre kandidatët me më së shumti vota të konsiderohen se janë të zgjedhur për anëtarë në Senat.
- 6) Për kandidatët të cilët kanë fituar vota të barabarta votohet për të dyten herë sipas rregullave të përshkruara më lartë.
- 7) Nëse kandidatët edhe pas tri radhëve të votimit kanë vota të barabarta, vendimi për kandidatët e mbetur bëhet përmes shortit.
- 8) E tërë procedura e votimit duhet të zhvillohet nga komisioni zgjedhor i përbërë prej tre anëtarëve, në përbërje të kryetarit dhe dy anëtarëve tjerë (duke përjashtuar kryetarin dhe nënkryetarin) që zgjedhën nga PS me shumicë të thjeshtë votash.
- 9) Në rast të dorëheqjes së hershme të njërit nga anëtarët student të Senatit, kandidati pasues me më së shumti vota nga regjistri burimor (fillestar) automatikisht është anëtarë i Senatit.

XIII. Mbajtja e rendit gjatë mbledhjes

Neni 18

- 1) Kryesuesi është përgjegjës që të mbajë rendin në mbledhje.
- 2) Kryesuesi dhe të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje të PS janë të obliguar të respektojnë këtë rregullore.
- 3) Për shkeljen e rendit në mbledhje mund të shqiptohen këto masa:
 - Paralajmërim;
 - Marrja e fjalës;
 - Përjashtim nga mbledhja.
- 4) Një paralajmërim mund të i shqiptohet anëtarit të pranishëm, nëse ai/ajo me sjelljen e tij/saj dhe më mënyrën e diskutimit vështirëson ose krijon obstrukcione në procedim normal të mbledhjes.
- 5) Marrja e fjalës i shqiptohet anëtarit i cili përmes sjelljes dhe fjalimit pengon procedimin normal të mbledhjes vetëm pasi që i është dhënë paralajmërimi.
- 6) Paralajmërimi jepet nga kryesuesi.
- 7) Marrja e fjalës shqiptohet nga kryesuesi.
- 8) Anëtari përjashtohet nga takimi nëse atij edhe pas i është marrë fjala, ai/ajo ka vazhduar të pengoi mbledhjen.
- 9) PS vendos me shumicë të thjeshtë të votave për përjashtimin e anëtarit nga mbledhja. Anëtari i cili është udhëzuar t'a leshoj mbledhjen, është i obliguar menjëherë të veproi sipas rregullit. Anëtari largohet vetëm nga ajo mbledhje.

Procesverbali i mbledhjes
Neni 19

- 1) Procesverbali duhet të mbahet për secilin takim të PS, i cili duhet të nënshkruhet nga Kryesuesi dhe Sekretari pas takimit në mënyrë të rregullt. Në rast të mungesës së Sekretarit, Kryesuesi cakton përkohësisht një person për mbajtjen e procesverbalit.
- 2) Procesverbali duhet të përmbajë elementet si në vijim:
 - a) Vendin, datën, kohën e fillimit dhe të mbarimit të mbledhjes;
 - b) Rendin e ditës;
 - c) Listën e pjesëmarrësve;
 - d) Të gjitha kërkesat dhe vendimet përkatëse;
 - e) Përshkrimin e përgjithshëm të zhvillimit të diskutimeve;
- 3) Dokumentet tjera shtesë duhet të bashkengjiten si aneks në procesverbal.
- 4) Procesverbali duhet të përgatitet brenda një jave pas mbledhjes dhe duhet të shpërndahet te të gjithë anëtarët e PS si një ekstrakt atëherë kur shpërndahen edhe materialet për mbledhjen e radhës të PS.
- 5) Procesverbali aprovohet në mbledhjen vijuese të PS.
- 6) Procesverbali duhet të arkivohet bashkë me të gjitha materialet sipas radhes dhe rendit të ditës si dokumentacion afatgjatë. Sekretarit të Përgjithshëm i dorëzohet nga një kopje relevante e materialeve nga Sekretari përkatës një herë në semester.

XIV. Puna e Komisioneve
Neni 20

Parlamenti i Studentëve mund të formojë komisione. Komisionet janë trupa ndihmës të PS. Komisionet mund të jenë të përhershme apo të përkohshme sipas fushave përkatëse. Komisionet mund të kenë më së shumti deri në pesë anëtarë.

Kompetencat e tjera të Kryetarit/es të PS
Neni 21

- 1) Krytari/ja e PS mund t'a përfaqësoi PS në institucione publike dhe private, por paraprakisht duhet t'a marrë miratimin e shumicës së anëtarëve të PS.
- 2) Kryetari/ja e PS mund të thirret në emër të PS vetëm atëherë kur merr miratimin nga PS me shumicë të votave të anëtarëve të PS.
- 3) Kompetencat e tjera e që nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore, e që kanë të bëjnë me kompetencat e Kryetarit/es së PS, delegohen nga PS me shumicën e votave të anëtarëve të PS.

Ndikimet politike
Neni 22

- 1) Të gjithë anëtarët e PS në momentin e marrjes së mandateve formalisht dhe deri në momentin e dorëzimit të mandatit të tyre nuk mund të jenë pjesë e strukturave drejtuese politike.
- 2) Përfshirja e anëtarëve të PS në aktivitete politike gjatë ushtrimit të ndonjërit nga funksionet e PS në të njëjtën kohë ndalohet me këtë rregullore dhe ndëshkohet me këto masa:
 - 2.1) Shkarkimin e tij/saj pa marrë parasysh pozitën në PS, duke përfshirë edhe pozitën e kryetarit/es.



- 2.2) Varësisht prej aktivitetit politik që vlerësohet nga PS, PS mund të marrë vendim që anëtarit/es t'i tërhiqet vërejtja e fundit me shkrim, në të kundërtën shqiptohet pika 2.1 e këtij neni.

Aktivitetet e Parlamentit Studentor **Neni 23**

- 1) Parlamenti Studentor përmes mekanizmave ligjor përkushtohet në avokimin dhe mbrojtjen e të drejtave të studentëve të cilat janë të përcaktuara me Statutin e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.
- 2) Parlamenti Studentor përkushtohet në përfaqësimin dinjitoz të studentëve, në organet e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.
- 3) Parlamenti Studentor ka të drejtë të organizoi aktivitete shkencore (konferenca shkencore, tryeza shkencore, hulumtime shkencore si dhe debate shkencore).
- 4) Parlamenti Studentor gjithashtu ka për detyrë që për çdo vit të publikoj nga një revistë studentore të karakterit shkencor.
- 5) Realizimi i bashkëpunimit me institucione publike dhe private për realizimin e praktikës profesionale, në koordinim me zyren e Karrierës dhe Bordin e Alumnit.
- 6) Realizimin e bashkëpunimit ndërmjet Parlamentit Studentor dhe Universitetit "Haxhi Zeka" në zhvillimin e programeve të profilizuara për nivelin e studimeve postdiplomike.
- 7) Parlamenti Studentor mund të organizoj puntori që kanë për qëllim implementimin e njohurive praktike.
- 8) Ndërmarrjen e iniciativave sensibilizuese për mundësitë që i ofrojnë organizatat ndërkombëtare për studime jashtë vendi.
- 9) Ndërmarrjen e iniciativave sensibilizuese lidhur me të drejtat dhe obligimet e studentëve karrshi statutit dhe kodit të etikës së UHZ-së.
- 10) Organizimin e shkollave verore që kanë për qëllim shkëmbimin e përvojave ndërmjet studentëve të Universitetit tonë dhe studentëve të Universiteteve të tjera.
- 11) Organizimin e aktiviteteve që promovojnë traditat, kulturat dhe zakonet e shtetit të Republikës së Kosovës.
 - 11.1) Organizimin e aktiviteteve humanitare.
 - 11.2) Organizimin e tournamentëve sportive.
 - 11.3) Si dhe aktivitete të tjera që kanë për qëllim stimulimin e studentëve përmes aktiviteteve të ndryshme studimore.

XV. Dispozitat përfundimtare **Neni 25**

Dispozitat e kësaj rregullore vlejnë për anëtarët e Parlamentit Studentor dhe për të gjithë personat e tretë të ftuar apo të kyqur në procedurat e PS.

Përgjashtimet nga Rregullorja **Neni 26**

- 1) Për çështjet të cilat nuk janë paraparë në këtë Rregullore, zbatohen dispozitat e Statutit të Universitetit të UHZ-Pejë dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës.
- 2) Për të gjitha rastet e vendimeve apo procedurave në lidhje me këtë Rregullore, Keshilli Drejtues i Universitetit duhet të jetë instanca e fundit e vendimmarrjes.

- 3) Në rast të kundërshtimit ndaj vendimeve të Këshillit Drejtues duke u bazuar në paragrafin 2 të këtij neni, të cilat në mënyrë serioze ndikojnë në punën dhe mandatin e Parlamentit Studentor dhe në Këshillat përkatëse të studentëve e që kanë bazë të fortë, mund t'i drejtohen me shkrim Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Implementimi i Rregullores
Neni 27

- 1) Kryesuesi i Parlamentit Studentor dhe Kryesuesit e Këshillave përkatëse studentore janë përgjegjës për implementimin e kësaj Rregullore.
- 2) Interpretimi autentik i kesaj rregullore mund të jepet nga Sekretari i Përgjithshëm në emër të Këshillit Drejtues.
- 3) Rregullorja hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi me datën e miratimit nga ana e Këshillit Drejtues të Universitetit.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Nur Çeku

Universiteti "Haxhi Zeka"



Pejë, më 13/07/2017

UNIVERSITETI